



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
 AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
 AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION



Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1, nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., pika 1.1.1., nenit 12 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5. dhe nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (tutje: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), nenit 11 paragrafi 4 dhe 5, si dhe nenit 12 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7. të Rregullores Nr. 03/2023, për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 06.02.2025, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti APK-DPKI-06-1183/24, për zyrtarin e lartë publik znj. Valbona Ahmeti-Makolli, Drejtoreshë e Drejtorisë së Financave në Komunën e Prishtinës, për shkak se nuk ka prova që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi për zyrtaren znj. Valbona Ahmeti-Makolli, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka filluar trajtimin e këtij rasti pas pranimit të një kërkesë me shkrim (DPKI-06-1183/24), përmes së cilës është kërkuar sqarim, nëse ekziston konflikti i interesit për zyrtaren znj. Valbona Ahmeti-Makolli, Drejtoreshë për Financa në Komunën e Prishtinës, e cila njëkohësisht ushtron autorizime në cilësinë e Zyrtarit Kryesor Financiar, gjë e cila (sipas raportuesit) konsiderohet si shkelje e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike si dhe Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Konform nenit 22, paragrafin 3, dhe 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit (DPKI-06-1439/24).

Me qëllim të sqarimit të plotë dhe të gjithanshëm të këtij rasti, në ambientet e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit është realizuar një takim me znj. Ahmeti-Makolli, ku janë diskutuar dhe shtjelluar çështjet që kanë të bëjnë me rastin në fjalë, ndërsa e njëjta ka paraqitur sqarimet e saj lidhur me pretendimet e ngritura duke theksuar se nënshkrimin e Deklaratës së

Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve (Nr. 646-24) e ka bërë në mungesë të ZKF dhe me autorizim përkatës.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pretendimet e raportuesit të rastit i ka trajtuar në kontekst ndalesave apo kufizimeve të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, të cilat përcaktohen si situata të konfliktit të interesit apo papajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik.

Vështuar nga aspekti administrativ i rregullimit dhe përcaktimit me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me *vendimmarrjen* e zyrtarit në një çështje të caktuar, në të cilën zyrtari ka apo mund të ketë *interes privat* për vete apo për *personat e afërm*. Kështu, me nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që: *“Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare”*, ndërsa neni 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 përcakton se: *“interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste”*.

Ndërsa sa i përket papajtueshmërive në ushtrimin e funksionit publik, Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në nenin 13 ka përcaktuar se:

“1. Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit.

2. Zyrtari i lartë nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një organi drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike, shoqërisë aksionare me pronë publike si dhe organeve të institucioneve të tjera publike, përveç nëse parashihet ndryshe shprehimisht me ligj. Zyrtari i lartë, në cilësinë e anëtarit të organeve të përmendura në këtë paragraf, nuk ka të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të.”

Në këtë kontekst, në kuptim të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit mbajtja e njëkohshme e pozitës së Drejtoreshës së Financave në Komunën e Prishtinës dhe asaj të Zyrtarit Kryesor Financiar nga znj. Ahmeti-Makolli, nuk konsiderohet konflikt interesi apo papajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërsa, në kontekst të rregullativës së brendshme të Komunës së Prishtinës, në një përgjigje të drejtuar znj. Ahmeti-Makolli, menaxheri i personelit në Komunën e Prishtinës ka sqaruar se “pozita “Zyrtar Kryesor Financiar” nuk ekziston në katalogun e vendeve të punës....”.

Pastaj, lidhur me rastin Agjencia i është drejtuar me një kërkesë për sqarim edhe Thesarit të Kosovës -MFPT, të cilët në përgjigjen e tyre kanë theksuar se *“Në bazë të kërkesës tuaj ju lutemi gjeni të bashkangjitura autorizimet për vitin 2024 për zyrtaret financiar nga ana e Kryetarit të Komuna Prishtinë.”*, ndërsa në listën e bashkangjitur me numër të protokollit



10-400/01-11054/24 e datës 19.01.2024, në cilësi të ZKF-së figuron znj. B.Sh-S, ndërsa znj. Ahmeti-Makolli nuk figuron të ketë ndonjë autorizim përkatës, me përjashtim të pozitës së drejtorit të financave.

Përkitazi me situatën në fjalë, Agjencia ka kërkuar një interpretim nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, të cilët në përgjigjen e tyre kanë referuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike, të cilat dispozita rregullojnë funksionin e Zyrtarit Kryesor Financiar (neni 12), zbatimin e këtij ligji në nivelin komunal (neni 57), statusin e Zyrtarit Kryesor Financiar (neni 12, paragrafi 3), duke shtuar se “sipas dispozitave të lartcekura vlerësojmë se pozita e Zyrtarit Kryesor Financiar ka statusin e nëpunësit civil dhe për të njëjtën çështja duhet referuar Ministrisë së Punëve të Brendshme.”

Sa i përket çështjes së delegimit të autorizimeve nga ZKA, për ndërmarrjen e veprimeve përkatëse në kuptim të zhvillimit të procedurave të prokurimit apo çështjeve financiare, dhe procedurave tjera të cilat rrjedhin nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe akteve ligjore që derivojnë nga i njëjti, janë jashtë sferës së Agjencisë, dhe të njëjtat duhet adresuar/rregulluar nga institucionet kompetente.

II. Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik janë përfundimtare në procedurën administrative, dhe bëhen publike në faqen zyrtare të Agjencisë, konform nenit 22, paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Yll Buleshkaj
Drejtör i Agjencisë
për Parandalimin e Korrupsionit